



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 1035/11 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012.

SHOQËRISË “FAFA” SH.P.K  
Bulevardi Blu, Zona kadastrale 8320, Bashkia Kamëz, Qarku Tiranë

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “FAFA” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj”, Komuna Derjan, rrethi Mat.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.571, datë 31.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.1035, Prot, datë 01.02.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj”, Komuna Derjan, rrethi Mat pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2020-2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj”, Komuna Derjan, rrethi Mat që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj”, Komuna Derjan, rrethi Mat.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

